

Raport për rezultatet e konsultimeve publike

1. Titulli i draft aktit

Projekt ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 93, datë 27.07.2015 "Për Turizmin", të ndryshuar".

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka hedhur projektligjin e propozuar në faqen e regjistrit elektronik të njoftimit dhe konsultimit publik (RENJK <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/662>), më datë 03.10.2023 duke i dhënë mundësi publikut, grupeve të interesit dhe komunitetit të biznesit të shprehin mendimet e tyre. Ky njoftim qëndron ende i afishuar në faqen zyrtare të konsultimit publik.

Gjithashtu, duke qënë se projektligji lidhet me sektorin e turizmit, MTM ka organizuar dhe dëgjuesën publike me grupet e interesit pranë ambienteve të ministrisë së Sipërmarrjes dhe Klimës në biznes në datat 20/21/22 Shtator 2023 ku u diskutuan me të pranishmit projektligji, synimet dhe objektivat e tij. Po ashtu, u dëgjuan me shumë vëmendje dhe komentet e sugjerimet e tyre të cilat u trajtuan me shumë prioritet dhe u reflektuan në draftin e projektligjit, të konsoliduar, ku theksi u vendos kryesisht për marrjen e masave për formalizimin e tregut, lehtësimin e kriterëve dhe procedurave, shtimin e masave administrative etj me synim realizimin e qëllimit të përbashkët, rritjen e standartit në turizëm.

3. Metoda e konsultimit

Për këtë projekt ligj janë ndjekur 2 metoda konsultimi:

1. Konsultimet elektronike – projekt ligji është publikuar në faqen zyrtare të konsultimit publik nga data 03 tetor 2023 dhe qëndron ende i publikuar, (RENJK <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/662>);

2. Takimet publike – Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Ministren e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit kanë organizuar disa tryeza konsultimi me grupet e interesit, konkretisht:

- Subjekte që ushtrojnë veprimtari si struktura akomoduese – 20.09.2023
- Subjekte që ushtrojnë veprimtari si restorante- 20.09.2023
- Operatorë turistikë dhe agjenci udhëtimi – 21.09.2023
- Udhërrëfyes turistik – 22.09.2023
- Sektorin akomodues – 22.09.2023
- Takim me bizneset e turizmit për lehtësimin e shërbimeve, me prezencën e Krveministrit 03.10.2023.

Palët u ftuan për pjesëmarrje nëpërmjet postës elektronike.

4. Palët e interesit të përfshira

Subjekte që kanë shprehur komente përmes konsultimit publik:

- Active Albania

- Unioni Turistik Shqiptar
- Shoqata e Agroturizmit Shqiperi
- Unioni Turistik Shqiptar/Enton Diamant
- Dhoma Amerikane e Tregtisë
- Shoqata Shqiptare e Turoperatoreve & Agjencive Turistike
- Kompania e Sigurimit SIGAL

Tryeza të rrumbullakëta

Restorante:

- Rozafa
- The Crown Tirana
- Restorant Aragosta
- Restorant Panorama
- Shoqata e Restoranteve
- Blerina Farm
- Luga e Argjente
- Ceren Ismet Shehu

Struktura akomoduese

- Hilton Tirana
- Xheko Imperial
- Rafaelo Resort
- Hotel Plaza
- Kastrati Hotels
- Hotel Plaza
- Hotel Mondial
- Fafa Resort

Agjenci udhëtimi dhe operatorë turistikë

- Happy Tours
- Fibula Tours

Udhërrëfyes turistik

- Klinton Gërzhani - ATOA
- Giergji Skrame - Sigma + Udhërrëfyes
- Ardiana - Alikaj - Natga

- Artur Guni - Federata Alpinizmit dhe Turizmit Malor

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara
Grupet e interesit e mbështetën nismën për ndryshimin e ligjit 93/2015 "Për turizmin", i ndryshuar.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka hedhur projektligjin e propozuar në faqen e regjistrimit elektronik të njoftimit dhe konsultimit publik (RENJK <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/662>), më datë 03.10.2023 duke i dhënë mundësi publikut, grupeve të interesit dhe komunitetit të biznesit të shprehin mendimet e tyre. Ky njoftim qëndron ende i afishuar në faqen e konsultimit publik. Për projektligjin kanë ardhur komente nga:

- Active Albania
- Unioni Turistik Shqiptar
- Shoqata e Agroturizmit Shqiperi
- Unioni Turistik Shqiptar/Enton Diamant
- Dhoma Amerikane e Tregtisë
- Shoqata Shqiptare e Turoperatoreve & Agjencive Turistike
- Kompania e Sigurimit SIGAL

Komentet e subjekteve kanë ardhur në formë shkresore dhe nëpërmjet postës elektronike.

Për këtë projektligj kanë shprehur komente: Active Albania; Unioni Turistik Shqiptar; Shoqata e Agroturizmit Shqiperi; Unioni Turistik Shqiptar/Enton Diamant; Dhoma Amerikane e Tregtisë, Shoqata Shqiptare e Turoperatoreve & Agjencive Turistike dhe kompania e sigurimit SIGAL, ku:

Shoqata Active Albania ka sugjeruar njohjen automatikisht të udhërrëfyesit e rafting, e klasës së IV e më sipër, të cilët e kanë marrë certifikatën e rafting në një vend të Bashkimit Europian në mënyrë që ata të vijnë e të punojnë edhe në Shqipëri sipas nevojës, koment i cili nuk është marrë në konsideratë, pasi nëpërmjet këtij projektligji synimi është nxitja e tregut të punës vendas në fushën e turizmit.

Unioni Turistik Shqiptar ka sugjeruar që në përkufizimin e termit "Agjenci udhëtimi" të përcaktohet numri i personave në grup/minigrup, maksimumi deri në 9 persona. Ky sugjerom nuk u mor në konsideratë pasi përcaktimi i numrit të personave në grup është një kriter tejet kufizues. Ndërkohë që sugjerimi që termi "Agjenci udhëtimi" është përkufizim shumë i gjërë në krahasim me kompetencat e vërteta të një agjencie, u mor në konsideratë dhe u reflektua në riformulimin e këtij termi. Edhe propozimi për riformulimin e termit "Operatorëve të udhëtimit" është marrë në konsideratë dhe është reflektuar. Sa i përket komentit për kufizimet në hapësirën e mjedisit të punës dhe shtim të stafit me më shumë punonjës të kualifikuar, sqarojmë se nuk u mor në konsideratë pasi këto kritere janë kufizuese dhe për më tepër, në ditët e sotme ku të gjithë po orientohen drejt aplikimeve online and remote ëork. Po ashtu, vleresohet se nuk është kompetence e MTM, por e MSHMS. Sugjerimi për ndarjen në dy kategori të operatorëve turistikë në outgoing dhe incoming nuk u mor në konsideratë pasi ky ndryshim sjell detyrimin për pajisjen me licencë të posacme për këto kategori operatorësh, cka do të kërkojë ndryshim të ligjit për licencat si dhe VKM përkatëse. Sugjerimi për të përfshirë kritere me shtrënguese të arsimit, si diploma universitare e titullit të parë të studimeve, eksperiencë etj, nuk u mor në konsideratë kriteri aktual i ligjit nuk ul standartin e turizmit, përkundrazi i nxit më shumë të rinjtë të drejtohen shkollave profesionale. Shembull, ndjekja e një shkolle profesionale në fushën e turizmit dhe marrja e formimit të duhur nuk e ul standartin por e rrit atë. Sa i përket sugjerimit për rivlerësimin e nenit 52 të ligjit bazë, ku përcaktohen rastet e ndërprerjes së licencës, sqarojmë se kërkesa për heqjen e licencës për operatorët që ushtrojnë veprimtari sezonale është abuzive dhe e tepërt, ndaj nuk është marrë në konsideratë. Përsa i përket komentit në lidhje me tarifën e garancisë së sigurisë, sqarojmë se nuk është shfuqizuar po është parashikuar në nenin 64/1 "Detyrime të tjera për sipërmarrjet turistike".

Sugjerimi për përcaktimin e vlerës së kontratës së sigurimit nuk u mor në konsideratë pasi ky përcaktim nuk mund të kryhet nga ne, por i referohemi parashikimeve të ligjit "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit". Po ashtu, përcaktimi i vlerave financiare kryhet bazuar në ekonominë e tregut. Duke parë dhe nivelin e inflacionit, nuk propozohet përcaktimi i aforjeve të këtyre vlerave. Lidhur me sugjerimin që inspektorati në fushën e turizmit nuk duhet të shfuqizohet, sqarojmë se ky inspektoriat nuk është shfuqizuar, por kjo strukturë ka kaluar si pjesë përbërëse e AKB-së, në kuadër të ristrukturimit në agjenci rajonale. Për analogji, edhe inspektorati i mjedisit është pjesë e AKM, pra nuk ekziston si strukturë më vete. Përsa i përket propozimit për rishikimin e nenit 63, sqarojmë se u mor në konsideratë.

Shoqata e Agroturizmit Shqipëri ka dhënë sugjerim që lidhen me nenin 45/1, në pikën dy të tij: së pari: të shtohet afati i rinovimit të paracertifikates. Paracertifikata të rinovohet çdo 6 muaj në menyre që kontrolli i kryerjes së veprimtarisë së agroturizmit të mund të monitorohet; së dyti, të shtohet: anëtare në komisionin e dhënies së paracertifikates/ certifikatës të jenë pjestare të shoqatës së agroturizmit. Sqarojmë se këto sugjerime nuk janë marrë në konsideratë, pasi qëllimi i projektligjit është lehtësimi dhe nxitja e aktivitetit të Agroturizmit dhe vendosja e kushteve të tilla ka karakter pengues. Po ashtu, përfshirja e pjesëtarëve të shoqatës në komisionin që cënon ndershmërinë në vendimmarrje.

Unioni Turistik Shqiptar/Enton Diamant ka sugjeruar rishikim të përkufizimit 66, tek neni 4, të projektligjit mbi "sipërmarrjet turistike"; rishikim të nenit 8, pasi shprehet plotësisht kundër bashkimit të AKB-së me Inspektoriatin, si dhe të nenit 11/1, që lidhet me Këshillin Ndërinstitucional për Statistikat, sugjerime të cilat nuk janë marrë në konsideratë.

Dhoma Amerikane e Tregtisë ka sugjeruar përfshirjen paraprake të grupeve të interesit që veprojnë në sektorin e turizmit, pasi do të kishte qenë me vlerë për përmbajtjen e propozimeve të sugjeruara si dhe reflektimin e problematikave kryesore që biznesi ndesh në praktikë; Gjithashtu, një nga problematikat kryesore që vërehet në këtë projektligj është që nuk ka asnjë parashikim në lidhje me praktikën apo instrumentat digjitale që institucionet (qoftë Ministria qoftë AKT) do të përdorin për të implementuar dhe ndjekur zhvillimet dhe gjurmimin e të dhënave, transparencës, duke sugjeruar që shumë shërbime duhet të jenë të aksesueshme në e-albania. Gjithashtu ka dhënë komente mbi paqartësinë e Organizatës së Menaxhimit të Destinacionit (OMD) dhe cilat janë kriteret e përzgjedhjes së përbërjes së saj. Sqarojmë se sugjerimet e Dhomës Amerikane të Tregtisë janë vlerësuar dhe argumentuar sipas tabelës së raportit të konsultimeve publike.

Sa i përket sugjerimeve të **Shoqatës Shqiptare të Turoperatoreve & Agjencive Turistike** që lidhen me detajimin e përkufizimit të termit "operatori turistik" në dy grupe, rivelesimin e neneve 21 dhe 22 sa i përket kriterit të arsimimit; neneve 23 dhe 30 të projektligjit, sqarojmë se detajimet dhe vlerësimet e sugjerimeve të dhëna janë pasqyruar tek tabela e konsultimeve, që i bashkëlidhet praktikës së këtij projektligji.

Kompania e sigurimit SIGAL ka bërë disa sugjerime që lidhen me detyrimet e sipërmarrjeve turistike për ekspozimin e kontratës së sigurimit në një vend të dukshëm për publikun. Ky sugjerim është pranuar dhe reflektuar në projektligj. Gjithashtu, është sugjeruar përcaktimi i limitit minimal të përgjegjësisë për sigurimin e përgjegjësisë civile. Ky sugjerim nuk është marrë parasysh pasi procedura për sigurimin e përgjegjësisë ndaj palëve të treta do të kryhet në bazë të legjislacionit për sigurimet dhe risigurimet, i cili i parashikon këto limite.

MTM ka organizuar dhe dëgjesën publike me grupet e interesit si, subjekte që ushtrojnë veprimtari si struktura akomoduese, subjekte që ushtrojnë veprimtari si restorante, operatorë turistikë dhe agjenci udhëtimi, udhërrëfyes turistik, sektorin akomodues, bizneset e turizmit për lehtësimin e shërbimeve pranë ambienteve të ministrisë së Sipërmarrjes dhe Klimës në biznes në datat 20/21/22 Shtator 2023 ku u diskutuan me të pranishmit projektligji, synimet dhe objektivat e tij. Po ashtu, u dëgjuan me shumë vëmendje dhe komentet e sugjerimet e tyre të cilat u trajtuan me shumë prioritet dhe u reflektuan në draftin e projektligjit, të konsoliduar, ku theksi u vendos kryesisht për marrjen e masave për formalizimin e tregut, lehtësimin e kriterëve dhe procedurave, shtimin e masave administrative etj me qëllimin e përbashkët për të rritur standartin në turizëm.

Çështja adresuar	Komenti	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
<p>Njohja automatike e Certifikatës për specializim të vecantë "rafting" e klasës IV e lëshuar nga një vënd i Bashkimit Europian.</p>	<p>A do të ishte e mundur në nivel kombëtar në ministritë e kompetencës suaj të aktivizoni një kanal për të njohur automatikisht udhërrëfyesti e rafting, e klasës së IV e më sipër të cilët e kanë marrë certifikatën e rafting në nje vend të Bashkimit Europian në mënyrë që ata të vijnë e të punojnë edhe në Shqipëri sipas nevojës?</p>	<p>Active Albania</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Kjo kërkesë nuk pranohet pasi synimi ynë është nxitja e tregut të punës vendas.</p>
<p>Kërkesë për një dallim ndërmjet konceptit të agjencisë së udhëtimit dhe operatorit turistik.</p>	<p>Saktësim i konceptit dhe kompetencave të agjencisë së udhëtimit dhe operatorit turistik.</p>	<p>Unioni Turistik Shqiptar</p>	<p>U pranua. Reflektuar në pikën 1 të nenit 2 të projektligjit. Ndryshohet përkufizimi i "Agjencisë së Udhëtimit"</p>	
			<p>U vlerësua e nevojshme riformulimi i konceptit të "Agjencisë së</p>	
			<p>Udhëtimit" duke qënë se përkufizimi i mëparshëm ishte tejet i gjërë në</p>	

			krahasim me kompetencat e ushtrimit të veprimtarisë si agjenci.	
Ndryshimet e sipërfaqes së mjedisit të punës dhe numrit të punonjësve të kualifikuar për ushtrimin e aktivitetit si agjenci udhëtimi dhe operator turistik.	Rritjen e sipërfaqes së mjedisit të punës ku ushtrohet veprimtaria e operatorit turistik (jo më të vogël se 50 m ²) dhe agjencisë së udhëtimit (jo më të vogël se 25 m ²). Rritje në numër të punonjësve të kualifikuar për ushtrimin e aktivitetit. Jo më pak se 3 punonjës në agjenci dhe jo më pak se 8 punonjës për operatorët turistikë.	Unioni Turistik Shqiptar	U refuzua	Ndryshimet e sipërfaqes së mjedisit të punës dhe numrit të punonjësve nuk janë fushë e përgjegjësisë së MTM. Gjithashtu, me zhvillimet e reja teknologjike, tendenca drejt punës online po rritet dhe vendosja e kushteve të tilla është tejet kufizuese.
Ndarja e aktivitetit të operatorëve turistikë në dy kategori.	Të parashikohet ndarja e Operatorëve Turistikë në dy kategori si më poshtë: a. "Operator Turistik Dalës" (Outgoing) është operatori turistik që siguron shërbimet e përshkruara në nenin 50, ku destinacioni i përfshirë është jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë b. "Operatorë turistikë hyrës" (Incoming) është Operatori turistik që përgatit	Unioni Turistik Shqiptar/ Shoqata Shqiptare e Turoperatoreve & Agjencive Turistike.	U refuzua	Ky ndryshim sjell detyrimin për ndryshim të Ligjit Nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për Licencat, Autorizimet Dhe Lejet Në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar" si dhe VKM përkatëse të cilat nuk janë pjesë e fushës së përgjegjësisë së MTM.

	<p>sherbime turistike për klientët e një operatori turistik nderkombetare, vendi kryesor i ushtrimit të biznesit të cilëve është brenda territorit te Republikës së Shqipërisë.</p>			
<p>Kërkesa për të mos ndryshuar kriterin e arsimit për operatorët turistikë .</p>	<p>Kërkohe të ruhet niveli i kualifikimit të mëparshëm në zotërimin e një diplome universitare të ciklit të parë.</p>	<p>Unioni Turistik Shqiptar/ Shoqata Shqiptare e Turoperatorev e &Agjencive Turistike.</p>	<p>U Refuzua</p>	<p>Përfshirja e shkollës së mesme profesionale është një faktor nxitës për të rinjtë që ti drejtohen shkollave profesionale. Shembull, ndjekja e një shkolle profesionale në fushën e turizmit dhe marrja e formimit të duhur rrit cilësinë e shërbimit, profesionalizmin dhe standartin e turizmit në përgjithësi.</p>
<p>Kërkesë për vendosjen e tarifave të garancisë për operatorët dhe agjencitë e udhëtimit.</p>	<p>Projektligji nuk përcakton vlerat e kontrates per sigurimin e pergjegjesive. Neni 55 i ligjit baze nuk duhet te shfuqizohet, por duhet shtuar: Pika 3, Tarfat e siurimit te pergjegjesive, ose (Tarifat e Garancise).</p>	<p>Unioni Turistik Shqiptar</p>	<p>U refuzua</p>	<p>Garancia e sigurisë, nuk është shfuqizuar po kaluar në nenin 64/1 "Detyrime të tjera për sipërmarrjet turistike".</p> <p>Kërkesa për përcaktimit e vlerës së kontratës së sigurimit nuk</p>

				mund të kryhet nga ne pasi duhet të referohen në ligjin për "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit". Po ashtu, përcaktimi i vlerave financiare kryhet bazuar në ekonominë e tregut. Duke parë dhe nivelin e inflacionit, nuk propozohet përcaktimi i aforfe i këtyre vlerave.
Kërkesë për mos bashkimin e Inspektoratit të Turizmit me AKB.	Inspektorati duhet të ushtrojë veprimtarinë e tij si strukturë më vete dhe jo si pjesë e AKB duke qënë se qëllimi i krijimit të AKB-së lidhet kryesisht me planifikimin e territorit dhe dëkka me monitorimin e stacioneve të plazhit, ndërsa Inspektorati monitoron gjithë gamën e veprimtarive turistike;	Unioni Turistik Shqiptar/ Unioni Turistik Shqiptar/Enton Diamant	U refuzua	Inspektorati nuk është shfuqizuar. Është kaluar si pjesë përbërëse e AKB në kuadër të ristrukturimit në agjenci rajonale. Për analogji, inspektorati i mjedisit është pjesë e AKM, pra nuk ekziston si strukturë më vete. Sqarohet se në projektligj është parashikuar shtimi dhe fuqizimi i kompetencave të AKB në fushën e inspektimit.
Kërkesa për disa ndryshime në lidhje me transportin turistik.	Në nenin 63 të shtohet pika 3 (a,b,c) si më poshtë: a. Transportuesi turistik nuk lejohet që të ushtrojë veprimtari turistike si Operator turistik; b. Cdo shërbim për llogari të një operatori turistik	Unioni Turistik Shqiptar	U pranua dhe u reflektua në nenin 29 të projektligjit.	

	<p>duhet te jete i pajisur me kontrate sherbimi nga ky i fundit</p> <p>c.Certifikata per Transport turistik,(si nje nga elementet baze te paketes turistike) duhet te leshohet nga MTM.</p>			
<p>Kërkesë për parashikimin e nje neni për percaktimin e menyres edhe kriterëve të veprimtarise së vendparkimeve te kamperave.</p>	<p>Në funksion të pikës 15 të nenit 4 të ligjit bazë, të përcaktohet mënyra edhe kriteret e veprimtarisë së vendparkimeve të kamperave dhe të përcaktohet me ligj që kamperat të mos lejohen qe të vendosen jashtë vendparkimeve të miratuara nga autoritetet.</p>	<p>Unioni Turistik Shqiptar</p>	<p>U refuzua pjesërisht</p>	<p>Për përcaktimin e mënyrës dhe kriterëve të ushtrimit të veprimtarisë së vendparkimeve të kamperave, do të ketë një koment më specifik kur të përfundohet analiza e akteve nënligjore.</p>
<p>Të shtohet afati i rinovimit të paracertifikatës për veprimtarinë e Agroturizmit.</p>	<p>Të shtohet afati i rinovimit te paracertifikates. Paracertifikata te rinovohet cdo 6 muaj ne menyre qe kontrolli i kryerjes se verpimtarise se agroturizmit te mund te monitorohet.</p>	<p>Shoqata e Agroturizmit të Shqipërisë</p>	<p>U refuzua</p>	<p>Qëllimi i projektligjit është lehtësimi dhe nxitja e aktivitetit të Agroturizmit dhe vendosja e kushteve të tilla ka karakter pengues.</p>
<p>Kërkesë për shtimin e anëtarëve të Shoqatës së Agroturizmit në komisionin e vlerësimit</p>	<p>Në pikën 2 të nenit 45/1 kërkohet shtimi i anëtarëve të Shoqatës së Agroturizmit në komisionin e vlerësimit për dhënien e paracertifikatës/certifikatës së veprimtarisë së Agroturizmit</p>	<p>Shoqata e Agroturizmit të Shqipërisë</p>	<p>U refuzua</p>	<p>Kjo kërkesë refuzohet për shkak se përfshirja e anëtarëve të shoqatës, çënon parimet e transparencës dhe objektivitetit.</p>
<p>Sqarim terminologjie</p>	<p>Të përcaktohet ndryshimi mes sipërmarrjes turistike me sipërmarrje turistike (Paragrafi 31, neni 4 ne ligjin aktual);</p>	<p>Unioni Turistik Shqiptar/Enton Diamant</p>	<p>U refuzua</p>	<p>Nuk kemi të bëjmë me koncepte të njëjta. Sipërmarrës është individi që ushtron veprimtari turistike. Sipërmarrje</p>

				nënkupton veprimtarinë në fushën e turizmit.
Unifikim terminologjie	Ndryshimet e propozuara për nenin 4 pika 58) Koment: ".....ose e një ndërtese banimi, në të cilin ofrohet shërbimi i akomodimit për turistët". Duke qënë se tek përkufizimi i apartamentit përdoret "njësi banimi" sugjerohet të ketë uniformitet në të gjithë ligjin për terminologjinë e përdorur.	Dhoma Amerikane e Tregtisë	U pranua dhe u reflektua në pikën 3 të nenit 2 të Projektligjit	
Kërkesë për sqarim terminologjie	Sqarimin e funksionit të OMD	Dhoma Amerikane e Tregtisë	U pranua pjesërisht. OMD futet si koncept në këtë Projektligj duke i hapur rrugën më tej zhvillimit dhe rregullimit të tij më vonë.	Për analogji, Agroturizmi u fut si koncept në 2015 dhe sot ndodhemi në situatën ku Agroturizmi është i mirërregulluar dhe funksional.
Sqarim mbi mënyrën dhe formën e miratimit të projekteve dhe veprimtarive në fushën e turizmit	Ligji duhet të përcaktojë një minimum rregullash për organizimin e garës/konkursit/tenderit për financimin e projekteve, mënyrën sesi bëhet publikimi i garës, dokumentat që duhen dorëzuar. Në rastin konkret, supozohet që vetë Ministria të hartojë rregullat për dhënien e financimit dhe pastaj po kjo ministri të miratojë dhënien e fondeve.	Dhoma Amerikane e Tregtisë	U refuzua	Ligji aktual për turizmin i përjashton të gjitha projektet nga prokurimi publik. Pra kjo nuk është një risi që po silllet në këtë projektligj. Përkundrazi, lehtësohen procedurat e financimit të subjekteve private që organizojnë aktivitete turistike, kulturore etj nëpërmjet AKT. Procedurat për

				<p>miratimin e projekteve dhe veprimtarive në fushën e turizmit:</p> <p>a) Do të ndiqet e njëjta procedurë e thirrjes publike për projekte 1 herë ose dy herë në vit në varësi të fondeve dhe projekte-ve. Pra Open Call.</p> <p>b)-Në asnjë rast nuk aplikohet dhënia e fondeve në mënyrë të drejtëpërdrejtë. A s në rastet kur incimi i projekteve bëhet nga Drejtoritë e Përmbytjes.</p> <p>c)-Në rastin kur fondi i projektit tejkalon masën 50% të fondeve vjetore aplikohet e njëjta formë sikurse parashikohet në ligjin aktual.</p> <p>d)-Rregullat për organizimin e procedurave do të përcaktohen me tej me akte nënligjore.</p>
Sqarim terminologjie	Përcaktimi i duhur në projektin nëse "Kolegjiumi" është një organ ad-hoc apo është i përhershëm. Gjithashtu sqarimi se cilët do të jenë anëtarët e tij	Dhoma Amerikane e Tretisë	U refuzua	Në të treja rastet e parashikuara në ligj, do të ketë Kolegjium, anëtarët e të cilit vendosën në bazë të përmbytjes së projektit.

Sqarim terminologjie	Sqarimi i termit "Titullar" të parashikuar në nenin 31/3	Dhoma Amerikane e Tregtisë	U Refuzua	Titullar – titullari i AKT(drejtor i përgjithshëm)
Kërkesë për mosregjistrimin në QKB të strukturave të vogla akomoduese.	Parashikimi i një regjimi të vecantë tatimor që ti lejoje subjektet të ofrojnë veprimtari si struktura akomoduese në platformat online si Air b&b dhe Booking pa u regjistruar në QKB.	Dhoma Amerikane e Tregtisë	U refuzua	Projektligji nuk synon ndërhyrje në platformat Air b&b dhe Booking pasi ky është një sektor i MFE. Detyra e MTM nëpërmjet këtij projektligji është legjitimimi i të gjithë sektorit të turizmit për të ruajtur konkurrencen e ndershme dhe përgjegjësitë ligjore që rrjedhin nga ushtrimi i aktivitetit ekonomik.
Kërkesë për lehtësimin e procedurave për strukturat e vogla akomoduese.	Parashikimi i procedurave të thjeshtezuara lidhur me subjektet që ofrojnë veprimtari si struktura akomoduese të vogla si dhoma për plazh/fjetje apo dhe bujtina me 1-6 dhoma.	Dhoma Amerikane e Tregtisë	U refuzua	1-6 dhoma përben strukturë akomoduese në kuptim të ligjit për turizmin dhe për këtë arsye nuk mundet të thjeshtohen procedurat.
Kërkesë për zbatimin e direktivës europiane te paketave të udhëtimit	Ligji duhet të parashikojë qartë detyrimet që lindin për mbrojtjen e konsumatorit sipas ligjeve të aplikuara në EU nëpërmjet mekanizmit të pranimiit që në momentin e liçensimit dhe të pranojnë zbatimin e detyrueshëm psh të "European Travel Package Directive"- paketë ligjore që siguron standartet për çdo aktor në zinxhirin e ofrimit të shërbimeve turistike / udhëtimit / akomodimit etj.	Dhoma Amerikane e Tregtisë	U refuzua.	Ky është një detyrim që vjen pas negociimit të kapitullit të II. Pra, ka një kalendar specifik.

Kërkesë për ndryshimin e ndarjes së hapësirave në stacionet e plazhit.	Në përputhje me modelet e vendeve europiane, propozohet që të garantohen hapësira publike të së njëjtës sipërfaqe në krah të cdo stacioni plazhi privat. Ligji duhet të përcaktojë një minimum 50% për hapësirën publike.	Dhoma Amerikane e Tregtisë	U refuzua	Në bazë të VKM-së nr. 171 datë 27.03.2019 për stacionet e plazhit parashikohet ndarja e sipërfaqes 70%/30%.
Kërkesë për heqjen e detyrimit të afishimit të cmimeve për Operatorët Turistikë dhe Agjencitë e Udhëtimit	Në nenin 64/1 "detyrime të tjera për sipërmarrjet turistike" sygjerohet te perjashtohen Operatorët Turistikë dhe Agjencitë e Udhëtimit nga detyrimi për afishimin e cmimeve.	Shoqata Shqiptare e Turoperatorev e & Agjencive Turistike.	U pranua dhe u reflektua ne pikën 2 të nenit 64/1.	
Kërkesë për rishikimin neni	Në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, sygjerohet heqja e pikës 3 të nenit 64/1 sepse eshte kerkese logjike te punes se gjithsecilit.	Shoqata Shqiptare e Turoperatorev e & Agjencive Turistike.	U refuzua	Propozimi për heqjen e pikës 3 të nenit 64/1 është i papranueshëm pasi është vendosur në ligj me qëllim ruajtjen e standartit ne turizem.
Heqja e detyrimit të ruajtjes së të dhënave nga Operatorët Turistikë dhe Agjencite e Udhëtimit.	Sygjerohet që kjo ruajtje kohore te hiqet, sepse bizneset perkatëse I raportojne njehere këto të dhëna në strukturat shtetërore.	Shoqata Shqiptare e Turoperatorev e & Agjencive Turistike.	U refuzua	Të dhënat do të ruhen në formë elektronike ne kuadër të detyrimit për transparencë.
Kërkesë për afishimin në vënd të dukshëm të kontratës së sigurimit	Sipërmarrësi turistik përfshire po pa u kufizuar edhe çdo strukturë akomoduese, operator turistik apo agjenci udhëtimi ka detyrimin te vendosë sigurimin e përgjegjësishë ndaj paleve te treta, në një vend te dukshem per publikun si	Kompania e Sigurimit SIGAL	U pranua dhe u reflektua me shtimin e pikes 5 ne nenin 64/1 te projektligjit	

	dhe të informoje konsumatorin.			
Kërkesë për përcaktimin e limitit minimal të përgjegjësive për sigurimin e përgjegjësive civile		Kompania e Sigurimit SIGAL	U refuzua	Ky sugjerim është refuzuar pasi procedura për sigurimin e përgjegjësive ndaj palëve të treta do të kryhet në bazë të legjislacionit për sigurimet dhe risigurimet, i cili i parashikon këto limite
Riformulim	Të riformulohet pika 4 e nenit 64/1, si më poshtë: "4. Çdo sipërmarrës turistik përfshirë po pa u kufizuar edhe çdo strukturë akomoduese, operator turistik apo agjenci udhëtimi, gjatë ushtrimit të veprimtarisë përgjatë gjithë periudhës të ushtrimit të veprimtarisë duhet të zotërojë një kontratë të vlefshme sigurimi për sigurimin e përgjegjësive civile ndaj palëve të treta për çdo dëmtim trupor shëndetsore përfshirë humbjen e jetës aksidentale dhe dëme të pronës të lëshuar nga një shoqëri sigurimi që ushtron veprimtarinë në territorin e Republikës të Shqipërisë."	Kompania e Sigurimit SIGAL	U pranua pjesërisht	Pika 4 e nenit 64/1 nuk është ndryshuar, pasi propozimi i ardhur është parashikuar në projektligj dhe sugjerimi është vetëm për riformulim